



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT GENC MEREPEZA

Nr. 15, datë 22.02.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Kleada Mersinllari	Kryesuese
Edona Dushaj	Relatore
Enton Radovan	Anëtar

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtare e Sekretariatit Teknik, znj. Ersila Kalaja, në datën 22.02.2024 ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Genc Merepeza**, me funksion aktual, Drejtor i Kabineti, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018** “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji relatimin e relatores së çështjes Edona Dushaj; dëgjoji subjektin e vlerësimit, z. **Genc Merepeza**, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 02.02.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e Drejtorit të Kabinetit , në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N:





I. RRETHANAT E ÇËSHTJES



1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Z. Genc Merepeza është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit të parë datë 05.04.2023 si Drejtor Kabineti në Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit .
3. Subjekti i vlerësimit, **Z. Genc Merepeza** iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7 datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit sipas ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin 1, datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Znj. Edona Dushaj, **Relatore**, Znj. Kleada Mersinllari, **Kryesuese** dhe Z. Enton Radovani, **Anëtar**.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr., 1,

datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Genc Merepeza.

6. Relatoria e çështjes, Znj. Edona Dushaj, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 18.04.2023 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatoria e çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit të mbështetur në nenet 33/1, nenin 42, nenin 46 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse deklaratimet e subjektit të vlerësimit, si më poshtë vijon:
 - a. me shkresën nr. *** prot, datë 19.04.2023, ka dërgua pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues;
 - b. me shkresën nr.*** prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit deklaratën e vlerësimit të aftësive profesionale;
 - c. me shkresën nr. *** prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - ✚ vlerësimin e pasurisë;
 - ✚ kontrollin e figurës;
 - ✚ vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a. Ligji nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
- c. Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”
- d. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”
- e. Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
- f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”
- g. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar” duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit që janë:

-  *Deklarata e Pasurisë,*
-  *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
-  *Formulari i Vlerësimit Profesional*
-  *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,*

- h. Raportet përmbledhëse të ILDKPKI-së, Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në AMP, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
 - i. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
 - j. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
 - k. ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.
13. Trupa e vlerësimit, më datë 19.12.2023, pasi dëgjoi relatorin, dhe krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Genc Merepeza, me Vendimin nr. 05, datë 19.12.2023 vendosi;
- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Genc Merepeza;
 - b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 -  *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 -  *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*

- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme , prej 5 ditëve për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.
14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
15. Në datën 29.01.2024, trupa e vlerësimit, njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 02.02.2024 ora 10:30, në ambiente e sallës së mbledhjes së Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Genc Merepeza, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të datës 26.01.2023, subjekti i vlerësimi z. Genc Merepeza kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 22.02.2024, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Me subjektin e vlerësimit është komunikuar me anë të postës elektronike, duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave. Subjekti i vlerësimit z. Genc Merepeza, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë hetimit.

II. VLERËSIMI I PASURISË

16. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit

të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.

17. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z. Genc Merepeza ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 07.03.2023. Formulari i Pasurisë ka nr.6 index, viti 2023 .
18. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
19. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridik, publikë apo privatë.
20. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

21. Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- ✚ deklaraten e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- ✚ raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- ✚ provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- ✚ dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

22. Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;

- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

23. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja;

ILDKPKI-ja, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport¹, të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Genc Merepeza, ku është konstatuar se:

- ✓ deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- ✓ nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ✓ nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- ✓ nuk është kryer deklarim i rremë;
- ✓ subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

A. PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

24. Bazuar në nenin 34, të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private sipas nenit 34 të ligjit 12/2018; (ç) deklaratimet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit; (dh) deklaratimet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

25. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllimin evidentimin e mungesës

¹ Raporti nr. 10/53, datë 31.07.2023, i ILDKPKI-së.

së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

III. DEKLARIM I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT, GENC ELEZ MEREPEZA **DEKLARIMI I PASURIVE**

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

Pasuria nr. 1.

1. Apartament banimi me sip.99 m2, nga të cilat 93.2 m2, është sipërfaqe banimi dhe pjesa tjetër është sipërfaqe e përbashkët në adresën “Rruga e ****”, Njësia nr.8 Ndërtesa nr. ****, hyrja nr.7, Tiranë . Nr. pasurie:***,.. Zona Kadastrale ****. Volumi: ****, Faqe:***,. Zyra e regjistrimit: ZVRPP Tiranë. Data e regjistrimit 29/08/2016. Vlera 69,300 euro. Pjesa Takuese :100% së bashku me bashkëshorten.

Burimi i krijimit: Kredi bankare në shumën 30,000 euro, në Abi Bank (ish Emporiki Bank) marrë në mars 2006 . Kredi e pashlyer.

Kredi konsumatorë në shumën 1.000.000 lekë në Raiffeisen Bank. Kredi e marrë nga bashkëshortja dhe e shlyer aktualisht .

Të ardhura në shumën 31.300 euro nga emigracioni me bashkëshorten dhe kursime familjare ndarë vite.

Të ardhura në shumën 1.300.000 lek nga shitja e 2000 m2 sip.toke në Pezë e Vogël, shitur në vitin 2011 për A.N dhe N.N ,

Bashkëlidhur Deklaratës

- Kontratë shitblerje nr. ***/rep/kol., datë 08.02.2016, ku Genc Merepeza blen nga shoqëria “****”sh.p.k. apartament me sip. 93.2 m2, në të cilën ambientet e përbashkëta zënë një sip. 6 m2, me adresë Rruga e ****, Tiranë. Çmimi i shitjes së pasurisë nr. ****është 69.300 euro dhe është likuiduar nga blerësi sipas kontratës së sipërmartjes nr.***rep /kol., datë 20.12.2015, me nënshkrimin e kontratës para noterit dhe regjistrimin e pronës me nr. pasurie ****, pronar i saj bëhet z. Genc Merepeza, i cili ka marrë këtë pronë në dorëzim që në vitin 2005.
- Certifikatë për vërtetimin pronësie ****, datë 21.04.2010, për pasurinë nr. ****, apartament me sip.93.2 m2, adresë Rruga e ****, Tiranë, në emër të **** sh.p.k. Kartela e pasurisë.

- Certifikatë për vërtetim pronësie ***, datë 29.03.2016, për pronësi me nr. ***, apartament banimi 93.2 m2, Tiranë në emër të Genc Merepeza. Kartela e pasurisë ku shuma e paguar është 69.300 euro. Harta treguese e regjistrimit.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **Ashk, Drejtoritë Vendore Tiranë**, me shkresën nr. ***, prot, datë 23.06.2023, dhe datë 26.06.2023, nuk e konfirmojnë pasurinë në emër të Genc Merepeza dhe Merita Durmishaj.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr.***, prot. datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD me nxjerrje llogarie në emër të Merita Durmishaj, ku figurojnë kredi në vlerën 1.000.000 lekë datë 18.06.2007, kredia në vlerën 999.432 lekë, datë 25.10.2013, dhe shlyer në vlerën 573.174 lekë, datë 12.12.2016.
- ✚ **ABI Bank**. me shkresën nr. ***, prot, datë 08.05.2023, konfirmon se Genc Merepeza ka marrë kredi hipotekore në shumën 30.000 euro, më datë 21.03.2006.
ABI Bank, me postë elektronike datë 27.06.2023, ka sjellë nxjerrjen e llogarisë bankare ku figuron disbursimi i kredisë më datë 21.03.2006, si dhe debitimi i shumës 29.000 euro në po të njëjtën datë me përshkrim “kalim nga Genc Merepeza tek Re fik *** për pagesën për blerje apartamenti”.

Në procesverbalin e datës 15.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit, subjekti ka sqarua: “*.kontrata e sipërmarrjes është lidhur në vitin 2005 dhe jo 2015 siç citohet në kontratën e shitjes datë 08.02.2016, shënimi në kontratën e vitit 2015 është lapsus/gabim material i noterit. Në kontratën e datë 08.02.2016, në faqen 3, paragrafi I, citohet se ... “Me nënshkrimin e kësaj kontrate para noterit dhe me regjistrimin e pronës me nr. pasurie ***, pronari i saj behët z. Genc Merepeza, i cili e ka marrë këtë pronë në dorëzim që në vitin 2005”. Pavarësisht se në kontratë është përcaktuar pagesa e këstit të parë prej 25000 euro , jashtë zyrës noteriale dhe kësti i dytë në shumën 44.300 euro me kredi nga banka, këto pagesa nuk janë kryer në këtë mënyrë. Në vitin 2005 është bërë pagesë parapagim pranë firmës 5000 euro. Me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes në vitin 2005, janë paguar 26.000 euro. Në ,mars 2006, pagesa e kryer nga Emprki Bank (ABI Bank-sot), në shumën 30.000 euro. Pagesa tjetër është bërë në dy këste: 6.000 euro në vitin 2011 dhe 2.300 euro në vitin 2015.*

*Për shkak të marrëdhënieve të afërta farefisnore me ndërtuesin, pagesat janë shtrirë në kohë. Këtë fakt e përforcon edhe marrja e kredisë në 2006. Gjithashtu, para lidhjes së kontratës së sipërmarrjes datë 20.12.2005, është lidhur kontrata nr. ***, datë 06.01.2005, për një apartament në pjesën e brendshme të kompleksit, në ndërtim e sipër (ndërtimi i të cilit në dijeni, ka përfunduar në 2007). Ndërkohë. Në kontakte të vijueshme me ndërtuesin, u vendos të merrej apartamenti*

*aktual, i cili ishte i përfunduar. Sqaron se për kontratën nr.***, datë 06.1.2005, nuk është kryer asnjë pagesë”.*

Subjekti paraqiti :

- Vërtetimin datë 19.06.2023, “ ***” sh.p.k., sipas së cilës Genc Merepeza ka blerë në 2005 apartament në kompleksin “***”, me çmim 69.300 euro, të cilat i ka likuiduar si në vijim:
 - Në vitin 2005, janë paguar 5.000 euro dhe po në dhjetor të këtij viti janë paguar 20.000 euro dhe 6.000 euro.
 - Në mars 2006, shuma 30.000 euro nëpërmjet kredisë në Emporiki Bank.
 - Në vitin 2011, shuma 6.000 euro
 - Në vitin 2015, pjesa e mbetur prej 2.300 euro.
 - Kontratë sipërmarrje datë 20.12.2005, me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep/kol., me investitor shoqëria “***” sh.p.k. dhe porosites Genc Merepeza, për apartamenti me sip. 99 m2 në Rrugën ***. Çmimi i shitjes 69.300 euro, nga të cilat kësti i parë prej 25.000 euro është paguar jashtë zyrës noteriale dhe kësti i dytë prej 44.300 euro , do të paguhej me kredi nga banka. Ndër të tjera citohet se: “Apartamenti do ti dorëzohet porositesit brenda muajt dhjetor 2016”, dhe se “Me këtë kontratë revokoj tërësisht Kontratën me nr. ***, datë 06.01.2005, duke e lënë atë pa fuqi (fq. 3, paragrafi i fundit)”.
 - Vërtetimin datë 19.06.2023 “ ***” sh.p.k., sipas së cilës Genc Merepeza ka blerë në 2005 apartament në kompleksin “***”.
- Lidhur me burimin e financimit nga emigracioni në Itali:

Subjekti i vlerësimit nga muaj mars 1998 deri në dhjetor 2002 ka qenë emigrant në Itali, sëbashku me bashkëshorten. Gjatë këtyre vitet subjekti shprehet se ka bashkëjetuar me znj. Merita Durmishaj . Paga e subjektit ka qenë rreth 3.000.00-3.200 lireta/ muaj, e në vijim rreth 1.200-1.300 euro/ muaj, pa përfshirë orët suplementare. Nga muaj prill 1998 deri më 21.05.2001, ka punuar në ndërtim te A.G.

Në procesverbaline datë 15.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit më, subjekti ka sqaruar: “...deri në nëntor 1998 puna e tij nuk ka qenë e deklaruar dhe pagesa ishte 15.000 lireta/ ora, ndërsa me fillimin e punës nën kontratë, paguhej 13.000 lireta/ ora .Gjatë kohës që ka punuar në ***S.P.A, Pagesa ka qenë rreth 1.130-1200 euro/muaj.

Gjithashtu ka deklaruar se për 5 vite ka marrë rrogën e 13 si dhe shpërblim për vitin e ri rreth 470 euro,. .(Pagar nga INPS).

*Bashkëshortja e subjektit ka qenë në marrëdhënie pune prej muajt të parë që kanë jetuar në Itali. (që me datë 29.05.1998, sipas kontratës së punës), punonte edhe në fundjavë në një studio avokatie, e quajtur ***, dhe paguhej 250 euro/muaj.*

Gjithashtu shprehet se për 5 vite ka marrë rrogën e 13 si dhe shpërblim për vitin e ri rreth 300 euro.(Paguat nga INPS).

Përveç pagesave në bankë janë marrë edhe pagesa cash, të cilat jepeshin nga pronarët për orët jashtë orari.

Gjithashtu, është përfituar ndihmë ekonomike, praktikë e ofruar nga shteti italian për familjet e reja dhe nivelin e pagesës.

*Për periudhën mars 1998- deri në marrjen e premesos, dhjetor 1998 , subjekti deklaroi se ka banuar te shtëpia e të afërmeve të vet në Via ***. (A. M.). Për periudhën janar-dhjetor 1999, ka banuar në shtëpinë e miqve të tij në adresën Via *** nr., ***, ku ka paguar 300.000 lireta në muaj për qira.*

*Nga data 02.01.2000 e deri në momentin e largimit nga Italia ka banuar në adresën Rruga “****” nr. ***, ku ka pasur edhe kontratë qiraje. Qiraja ka qenë 800.000 lireta/muaj dhe në vijim 400 euro/muaj. Gjatë kësaj periudhe, nga Komuna e Veronës, është bërë subvencionim rreth 3.000 euro/ viti, ndihmë që ka vazhduar veri në maj të 2001.*

Shpenzimet jetike për dy persona shkon rreth 600.000 lireta e në vijim rreth 300 euro/muaj.”

Subjekti shprehet se ka kursyer rreth 16.000 euro për periudhën që ka qëndruar në Itali shtuar kësaj edhe likuidacionin në përfundim të qëndrimit në Itali në shumën 8.500 euro (për të cilat nuk disponon dokumentacion vërtetues). Shuma totale shkon në 24.500 euro.

Trupa e vlerësimit pas shqyrtimit dhe administrimit të dokumentacionit të paraqitur dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i vlerësimit duke qenë se kishte paqartësi për nevojat të hetimit të gjithanshëm dhe të plotë, **në komunikimin me email të datës 4.10.2023**, subjektit , ju kërkua të jepte shpjegimet dhe të vinte në dispozicion, të Trupës së Vlerësimit, dokumentacionin vërtetues për faktin se gjatë deklarimeve shprehet se shpenzime jetike kanë qenë rreth 300 euro në muaj.

Subjekti me email- in e datës 09.10.2023 sqaroi: “...për blerje ushqimesh, vlera për dy persona nuk shkonte me shumë 300 Euro, +/- 10 euro. Flitet për vitet 1998 -2002, ishte në përdorim Lireta, dhe në vitin 2000 u zëvendësua nga Euro. Këto janë shpenzime që kanë të bëjnë me blerjet për ushqime bazike. Unë këtë kam kuptuar me nevojat jetike.

Përveç kësaj ka qenë dhe qiraja e banesës, ujë dhe drita 440-450 Euro në muaj. Totali shkonte 740-750 Euro në muaj. Dokumente për ta vërtetuar nuk disponoj”.

Subjekti paraqiti :

- Leje Qëndrimi (Promesso di Soggiorno) Nr. P**** DR. hyrjes në Itali 24.03.1998 data e lëshimit 7.1.1999. Genc Merepeza.
- Karta Identitetit Nr. AC *** për Genc Merepeza, datë 01.08.2000, rezidenca Verona,***.
- Kontratë individuale pune ndërmjet A. G. dhe Genc Merepeza, 30.11.1998. Pagesa 11.717 lirë/ora për 40 orë në javë. Data e regjistrimit të kontratës së punës 09.12.1998.

- Kërkesë për dhënien e librezës së punës për të huajt (Domanda di rilascio del libretto di lavoro a stranieri). Datë 30.08.1999. Punëdhënësi A. G.
- Deklaratë e punëdhënësit A. G., datë 1 shtator 1999, lëshuar punëmarrësit Genc Merepeza.
- Kontratë qiraje datë 09.12.1999, për banesën në Via ***, nr.***, Verona, lidhur ndërmjet R. M. dhe Genc Merepeza, më datë 09.12.1999, Afati 02.01.2000- 01.01.2004. Pagesa mujore 800.000 lireta.
- Kontratë pune provizore datë 21.05.2001, e vlefshme për 4 muaj provë, Prodotti *** S.P.A lidhur me punëmarrësin Genc Merepeza.
- Kontratë individuale pune nëpërmjet Prodotti **** S.P.A dhe Genc Merepeza, për fillimin e marrëdhënieve të punës me kohë të përcaktuar, datë 21.05.2001. Pagesa 21.05.2001-dhjetor 2001, shuma bruto 10.570 euro.
- Njoftim i Bankës ***, për riaktivizimin e Kartës së Bankës e datës 25.07.2000.
- Njoftim i Bankës ***, për lëshimin e kartës BANKOMAT.
- Deklaratë datë 14.05.2002 nga Prodotti *** S.P.A, sipas së cilës Genc Merepeza punon pranë kësaj firme (dokumenti lëshohet për rinovim Leje Qëndrimi).
- CUD 2002-Certifikatë e pagesës së kontributeve nga Prodotti *** S.P.A.
- Libreze saniate për Genc Merepeza, viti 2002.
- Busta Paga (Paga) nga A. G., muaj dhjetor 1999, shuma neto 588.000 lireta.
- Busta Paga (Paga) nga A. G., muaj nëntor 2000, shuma neto 747.008 lireta.
- Busta Paga nga Prodotti *** S.P.A, muaj tetor 2001, shuma neto 1.112 euro; nëntor 2001, shuma neto 1.1154 euro, muaj dhjetor 2001 shuma neto 1.130 euro , janar 2002, shuma neto 1.141 euro; shpërblim për vitin e ri, Genc Merepeza, shuma 489 euro.
- Njoftime Banka *** për rimbursimin e qirasë së banimit në emër të Genc Merepeza; datë 21.04.2000, shuma 2.780.000 lireta; datë 06.08.2001, shuma 3.400.000 lireta.
- Leje Qëndrimi (Permesso di Soggiorno) Nr. ***, datë 07.01.1999, data e hyrjes 24.03.1998. M.R.
- Kontratë pune me S. U., regjistruar me nr.***, datë 29.05.1998, me pagesë 10.910 lireta/ora. M.R.
- Kontratë pune me V.F., Rr.***, e datës 01.01.1999; pagesa 17.5 orë/javë dhe 12.500 lireta /ora. M. R.
- Njoftim datë 24.07.2002, për likuidim pagese me çek për ndihmë familjare, shuma 701 euro, në emër të Merita Durmishaj (gjithashtu vërteton ndryshimin e mbiemrit të bashkëshortes nga Rudho në Durmishaj).

Trupa e vlerësimit pas shqyrtimit dhe administrimit të dokumentacionit të paraqitur dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i vlerësimit konstatoj ndryshimin e mbiemrit të bashkëshortes së subjektit të vlerësimit.

Për nevoja të hetimit të gjithanshëm dhe të plotë në komunikimin me email të datës 4.10.2023 subjekti u pyet për faktin që se gjatë verifikimit të dokumentacionit të administruar ka rezultuar se znj. Merita gjatë kohës që keni jetuar në Itali ka ndryshuar mbiemrin nga **Rudho në Durmishaj**.

Subjekti me email- in e datës 09.10.2023 sqaroi: “...kur jemi larguar nga Shqipëria, bashkëshortja kishte akoma mbiemrin, **Rudho**. Në vitin 1999-2000, bashkëshortja mori mbiemrin, **Durmishaj**. Është e evidentuar ne Regjistrin e Gjendjes Civile. Shiko Certifikatën e martesës”.

Subjekti paraqiti:

- *Certifikata e Martesës. (1. Certifikate Martese ***)*

- Lidhur me burimin e financimit nga shitja e 2000 m2 sipërfaqe tokë.

Në procesverbalin e datë15.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqaruar: “...me kontratë nr. *** Rep.nr. *** Kol., datë 20.05.2011, ku pala shitëse: F.M, M.M., A.M., Genc Merepeza, A.M., V.M. dhe S. M., i shesim palës blerëse, N.P (Trajtimi i marrëdhënies me znj. më poshtë.) tokën 2000m2, Pezë e Vogël, Tiranë, në të cilën janë bashkëpronarë, në vlerën 1.300.000 lekë, vlerë e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Pavarësisht se toka ishte në bashkëpronësi me vëllain dhe motrat, gjithë shumën prej 1.300.000 lekë e ka përfutuar subjekti, në dakoratësi me njëri –tjetrin dhe për faktin se nga shtëpia e prindërve në Pezë të Vogël, nuk përfiton asgjë pasi ka hequr dorë”.

Subjekti paraqiti :

- Certifikatë për vërtetim pasurie ***, datë 17.01.2011, për pasurinë nr. ***, arë me sip. 2000 m2, Pezë e Vogël, Tiranë, në bashkëpronësi të familjes Merepeza, sipas listës bashkëlidhur ku Genc Merepeza figuron si bashkëpronar me 7/35 pjesë takuese. Lista është rrjedhojë e dëshmisë së trashëgimisë nr.***, datë 28.10.2010. Kartela e pasurisë me shënimin “regjistruar me D/trashëgimie”. Harta treguese e regjistrimit.
- Vendim nr. ***. Akti, nr.***, Vendimi, datë 05.09.2003, nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin E.M., duke përcaktuar trashëgimtarë ligjor të radhës së parë të tij, V. M., S.M, F.M., Genc Merepeza dhe A.M., të cilët trashëgojnë të gjithë në mënyrë të barabartë nga 1/5 pjesë takuese të të gjithë pasurisë së trashëgimlënësit.
- Vendim nr. ***. Regjistri themeltar, nr. ***, Vendimi, datë 12.10.2010, nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, për trashëgimlënësen B.M., duke përcaktuar trashëgimtarë ligjor të radhës së parë fëmijët e saj V. M., S.M, F.M., Genc Merepeza dhe A.M., dhe bashkëshortin E.M., i cili ka qenë gjallë

në kohën e vdekjes së të ndjerës B.M. Secili prej tyre trashëgon 1/6 pjesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, kudo ku ajo ndodhet.

- Deklaratë noteriale nr. *** rep. nr. *** kol., datë 20.06.2023, sipas së të cilës F. M., M. M., V.L., A.M. dhe A.M., deklarojnë se sipas kontratës së shitjes nr.*** rep/kol./, datë 20.05.2011, kanë shitur pasurinë nr. ***. Zk *** , vol.*** fq.***, e llojit tokë arë, ndodhur në Pezë e Vogël, Tiranë, me sip.2000 m2, kundrejt çmimit të përgjithshëm të shitjes 1.300.000 lekë. Me vullnet të lirë dhe të plotë, deklarojnë se kanë hequr dorë në mënyrë të pa revokueshme, nga pjesa takuese e çmimit të përgjithshëm të shitjes, duke ia kaluar Z. Genc Merepeza, për ti përdorur për blerjen e një apartamenti. Kopje e ID përkatëse.
 - Postë elektronike datë 16.06.2023, bashkëlidhur deklaratën e motrës S. M.L. e cila deklaron se ka pranuar me dëshirën e saj që shumën 1.300.000 lekë nga shitja e tokës me sip. 2000m2 në Pezë e Vogël, ta marr vëllai, Genc Merepeza, dukë qenë se ka blerë apartament në Tiranë tek Kompleksi ***. Kopje e ID. Subjekti sqaron se S. M.L., jeton në Genova, Itali dhe për këtë arsye, deklaratën e saj e ka përcjellë me anë të postës elektronike.
- Lidhur me kredinë konsumatorë në shumën 1.000.000 lekë në Raiffeisen Bank. Kredi e marrë nga bashkëshortja dhe e shlyer aktualisht .

Në procesverbalin e datë 21.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: *“...lidhur me deklarinimin si burim financiar për blerjen e apartamentit të banimit, të kredisë nga Raiffeisen Bank, në shumën 1.000.000 lekë, marrë në vitin 2007, ndërkohë që sipas dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria e ndërtimit, nuk figurojnë pagesa në këtë vit, subjekti u shpreh se kjo shumë është përdorur për mobilim. Shuma rreth 1.300.000 -1.500.000 lekë janë përdorur për mobilimit të shtëpisë dhe se është kryer ndër vite me anë të kursimeve familjare, kredisë së bashkëshortes si dhe financimit nga Raiffaisen Bank për disa blerje pajisjesh. Lidhur me këto blerje shprehet se nuk ka ruajtur fatura për shkak për kohës së gjatë që ka kaluar”*.

Konkluzion:

- ✓ Në lidhje me krijimin e kësaj pasurie trupa e vlerësimit ka realizuar kryqëzimin e informacionit të vënë në dispozicion duke krijuar analizimin e të dhënave nëpërmjet pasqyrës financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve në vite të subjektit të vlerësimit ka rezultuar se ka burim të ligjshëm .
- ✓ Burimi i financimit të apartamentit;
 - me të ardhurat nga emigracioni në shumën 31.300 euro, është krijuar gjatë periudhës mars 1998- dhjetor 2002. Në këtë rast zbatohet nenit 32 pika 2 “ Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin për të justifikuar

ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni nga viti 2008 dhe në vijim”.

- kredi bankare për blerje apartamenti në ABI Bank, në shumën 30.000 euro, marrë në datë 21.3.2006, akoma e pa shlyer.
- ✓ Trupa e vlerësimit pas shqyrtimit dhe administrimit të dokumentacionit të paraqitur dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i vlerësimit arrin në përfundimin së pagesat e kryera nga subjekti i vlerësimit sipas vërtetimit të paraqitur nga “**** ”sh.p.k. nuk përputhen me përcaktimet e kontratës së sipërmarrjes së nënshkruar në vitin 2005.
- ✓ Trupa e vlerësimit nga analizimi i dokumentacionit të administruar dhe kryqëzimi i informacionit të përfituar, zhvilloj hetim dhe nga verifikimi në sistemet e Policisë së Shtetit rezultoi se shtetësia N.P e cila në shtetin e Anglisë ka përdorur identitetin Sh. Gj. në datën 20.05.2011, nuk ndodhej në territorin e Republikës së Shqipërisë . Datë e cila përkon me datën që mban Kontrata e shitblerje me nr.*** Rep.nr.*** Kol., datë 20.05.2011.
- ✓ Rezultojnë shpenzime për mobilimin ndër vite, në total rreth 1.500.000 lekë. (1.000.000 lekë kredi nga Raiffeisen Bank në emër të bashkëshortes e shlyer dhe rreth 500.000 lekë kursime familjare). Hetimi i trupës së vlerësimit, referuar hetimit financiar ka konstatuar se subjekti i vlerësimit ka mundësi për kursimin e vlerës 500.000 lekë.
- ✓ ASHK nuk konfirmon pasurinë e deklaruar.

Pasuria nr. 2.

Tokë arë me sip. totale 878 m2, nr. pasurie ***, Zk ***, Tiranë. Data e regjistrimit 17.01.2011. Në bashkëpronësi me vëllain dhe motrat e mia. Vlera 0 Lekë. Pjesa takuese 20%.
Burimi i krijimit: Ligji nr. 7501 datë 19.07.1991, “Për tokën” i ndryshuar.

Pasuria nr. 3.

Tokë arë me sip. totale 1250 m2 nr. pasurie ***, Zk ***, Tiranë.. Data e regjistrimit 17.01.2011. Në bashkëpronësi me vëllain dhe motrat e mia. Vlera 0 Lekë. Pjesa takuese 20%.
Burimi i krijimit: Ligji nr. 7501 datë 19.07.1991, “Për tokën” i ndryshuar.

Pasuria nr. 4.

Tokë arë me sip. totale 10.000 m2 nr. pasurie ***, Zk ***, Tiranë. Data e regjistrimit 17.01.2011. Në bashkëpronësi me vëllain dhe motrat e mia. Vlera 0 Lekë. Pjesa takuese 20%.
Burimi i krijimit : Ligji nr. 7501 datë 19.07.1991, “Për tokën” i ndryshuar.

Bashkëlidhur Deklaratës

- Certifikatë për vërtetimin e pasurisë nr.***, datë 17.01.2011, për pasurinë nr. *** arë me sip. 878 m2, Pezë e Vogël, Tiranë, në emër të bashkëpronarëve të familjes Merepeza, sipas Listës bashkëlidhur, ku Genc Merepeza figuron si bashkëpronar me 7/35 pjesë takuese. Lista është rrjedhojë e dëshmisë së trashëgimisë nr.***, datë 28.10.2010. Kartela e pasurisë me shënimin “regjistruar me Dëshmi trashëgimie”. Harta treguese e regjistrimit.
- Certifikatë për vërtetimin e pasurisë nr.***, datë 17.01.2011, për pasurinë nr. *** arë me sip. 1250 m2, Pezë e Vogël, Tiranë, në emër të bashkëpronarëve të familjes Merepeza, sipas Listës bashkëlidhur, ku Genc Merepeza figuron si bashkëpronar me 7/35 pjesë takuese. Lista është rrjedhojë e dëshmisë së trashëgimisë nr.***, datë 28.10.2010. Kartela e pasurisë me shënimin “regjistruar me Dëshmi trashëgimie”. Harta treguese e regjistrimit.
- Certifikatë për vërtetimin e pasurisë nr.***, datë 17.01.2011, për pasurinë nr. *** arë me sip. 10000 m2, Pezë e Vogël, Tiranë, në emër të bashkëpronarëve të familjes Merepeza, sipas Listës bashkëlidhur, ku Genc Merepeza figuron si bashkëpronar me 7/35 pjesë takuese. Lista është rrjedhojë e dëshmisë së trashëgimisë nr.***, datë 28.10.2010. Kartela e pasurisë me shënimin “regjistruar me Dëshmi trashëgimie”. Harta treguese e regjistrimit.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

✚ **ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2**, me shkresën nr. *** prot, datë 07.07.2023, konfirmon në emër të Genc Merepeza, pasurinë ***, vol ***. Fq. ***. ZK***, arë sip. 10000 m2 si dhe ka bashkëlidhur;

- Kartelë pasurie për arë me sip. 10000 m2, Pezë e Vogël, Tiranë, në emër të F., M., A. dhe A. Merepeza, V. L., S. L., me shënimin “përfitur me dëshmi trashëgimie”
- Vendim nr. *** Akti, nr.*** Vendimi, datë 05.09.2003, nga Gjykata e Shkallës së Parë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin E. M.
- Vendim nr. *** Akti, nr.*** Vendimi, datë 12.10.2010, nga Gjykata e Shkallës së Parë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësen B. M.

✚ **Shkresë nr. *** prot, datë 26.07.2010**, nga Këshilli i Qarkut Tiranë “Përcjellje e dokumentacionit, për regjistrim prone” drejtuar ZVRPP Tiranë për pasuritë arë me sip. 10000 m2, 878 m2 dhe 1250 m2, plus praktika.

Certifikatë familjare e datë 01.08.1991,- Nr. ***, datë 13.07.2020.

Konkluzion:

- ✓ Deklarimi lidhur me pasuritë arë me sip.878 m2 dhe 1250 m2, bazohet në dokumentacionin e dorëzuar.

- ✓ ASHK nuk i konfirmon këto pasuri (në dokumentacionin e përcjelle nga ASHK, figuron kërkesa për regjistrimin e tyre).
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK për pasurinë are me sip. 10000 m2.

Pasuria nr. 5.

Automjet KIA, model Sportage me targa AA *** RL, vit prodhimi 2005, nr. shasie TI***TA, përfituar me kontratë shitje nr. rep. ***, nr., kol. ***, datë 04.05.2017.

Vlerës 500.000 lekë. Pjesa takuese 100% Burimi i krijimit kursime familjare ndër vite.

Bashkëlidhur Deklaratës

Kontratë shitblerje nr. ***rep.kol., datë 04.05.2017, ku Genc Merepeza blen automjetin KIA Sportage me targa TR***L, nr. shasie TI***TA, në vlerën 500.000 lekë.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

✚ **DPSHTRR**, më shkresën nr. *** prot, datë 12.05.2023, konfirmon se Genc Merepeza ka në pronësi automjetin me targë AA***RL. Bashkëlidhur kontratë shitje automjeti nr. rep.***, nr. kol.***, datë 04.05.2017. Vlera 500.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Në lidhje me krijimin e kësaj pasurie trupa e vlerësimit ka realizuar kryqëzimin e informacionit të vënë në dispozicion duke krijuar analizimin e të dhënave nëpërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve në vite të subjektit të vlerësimit.

Konkluzion:

- ✓ Automjeti në pronësi të subjektit është blerë në vitin 2017 me kursime familjare.
- ✓ Hetimi i trupës së vlerësimit, referuar hetimit financiar të kryer, nëpërmjet nxjerrjes së llogarive bankare, konstaton se të ardhurat e deklaruara nga subjektit të vlerësimit dhe bashkëshortes së tij deri në maj 2017, mundësojnë krijimin e shumës 500.000 lekë për blerje automjeti.

Pasuria nr. 6.

- Gjendje cash në banesë . Vlera 10.000 lekë. Pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit Kursime nga paga.

Konkluzion:

- ✓ Trupa e vlerësimit, referuar hetimit financiar të kryer, ka konstatuar se subjekti i vlerësimit ka të ardhurat të mjaftueshme për krijimin e gjendjes cash të deklaruar.

Pasuria nr. 7.

- Llogari bankare e pagës në Raiffeisen Bank, me nr. ***. Vlera 82.632 lekë, datë 06.03.2023. Pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit : Të ardhura nga paga.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr.*** prot, datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Genc Merepeza, Llogari page në vlerën 82.632 lekë, datë 07.03.2023.

Konstatohet:

- ✓ Hetimi i trupës së vlerësimit, referuar hetimit financiar të kryer, ka konstatuar se subjekti i vlerësimit ka të ardhurat e realizuara e justifikojnë krijimin e gjendjes të deklaruar.

IV. DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

Subjekti i vlerësimit Genc Merepeza ka dhënë këto deklarime të ardhurave në vite:

- Të ardhura nga paga në Policinë e Shteti, periudha 01.07.1985-31.01.1987. Komandant i PK Zogaj. Vështirësi shërbimi 500 lekë. Shuma 13.300 lekë.
- Të ardhura nga paga në Policinë e Shteti, periudha 31.01.1987-01.03.1992. Komandant i PKK Hani i Hotit. Vështirësi shërbimi 600 lekë. Shuma 45.600 lekë.
- Të ardhura nga paga në Policinë e Shteti, periudha 01.03.1992-06.12.1993. K/Degës së Shërbimeve të Policisë Kufitare. Shuma 42.400 lekë.
- Të ardhura nga paga në Policinë e Shtetit (plus pagesë shtesë për gatishmërinë, ushqim dhe kuotë solidariteti), periudha 01.05.1997-15.03.1998. Inspektor i Kufirit Tokësor në Drejtorinë e Policisë Kufitare në Ministrinë e Brendshme .Shuma 330.000 lekë.
- Të ardhura nga puna në emigracion, periudha 01.04.1998-30.11.2002 . Shuma 74.000 euro.
- Likuidicion i shkëputjes së marrëdhënieve të punës . Shuma 8500 euro.
- Të ardhura nga paga në Policinë e Shteti, periudha 16.07.2003-25.08.2004, me detyrë kontrollor në PKK Rinas. Shuma 499.100 lekë.
- Të ardhura nga paga në Policinë e Shtetit, periudha 25.08.2004-31.12. 2005, me detyrë komandant i Repartit të Policisë Kavajë. Shuma 689.938 lekë.

- Të ardhura nga paga në Policinë e Shtetit, periudha 01.01.2006-16.09.2006, me detyrë komandant i Repartit të Policisë Kavajë. Nga kjo datë e deri në fund të vitit 2006, me detyrë specialist i Sektorit të Kufirit të Gjelbër në DPPSH. Shuma 615.486 lekë.
- Paga, shërbime dhe pagesë uniforme për vitin 2007, me detyrë specialist i Sektorit të Kufirit të Gjelbër në DPPSH. Shuma 597.572 lekë.
- Paga, shërbime dhe pagesë uniforme për vitin 2008, me detyrë shef i Sektorit të Kufirit të Gjelbër në DPPSH. Shuma 815.681 lekë.
- Paga, shërbime dhe pagesë uniforme për vitin 2009, me detyrë Shef i Sektorit të Kufirit të Gjelbër DPPSH. Shuma 864.614 lekë.
- Paga, shërbime dhe pagesë uniforme për vitin 2010, me detyrë Shef i Sektorit të Kufirit të Gjelbër DPPSH. Pagesa jashtë orarit për punën në Grupin e Punës për plotësimin e pyetësorit për BE. Shuma 1.139.801 lekë.
- Paga, shërbime dhe pagesë uniforme për vitin 2011, me detyrë Shef i Sektorit të Kufirit të Gjelbër DPPSH. Shuma 1.151.708 lekë.
- Të ardhura nga shitja e 2000 m2 sip. Toke në Pezë të Vogël, shitur në vitin 2011. Shuma 1.300.000 lekë.
- Paga, shërbime dhe pagesë uniforme për vitin 2012, me detyrë Shef i Sektorit të Kufirit të Gjelbër DPPSH. 957.978 lekë.
- Paga, shërbime dhe pagesë uniforme për vitin 2013, me detyrë Shef i Sektorit të Kufirit të Gjelbër DPPSH. Shuma 976.196 lekë.
- Paga, shërbime dhe pagesë uniforme për vitin 2014, me detyrë Shef i Sektorit të Kufirit të Gjelbër dhe ZV/Drejtor i Përgjithshëm për K&M (SHTATOR 2014). Shuma 1.416.693 lekë.
- Paga, shpërblime , pagesa leje e zakonshme dhe pagesa uniforme në Policinë e Shtetit për vitin 2016, si Drejtor i Përgjithshëm K&M. Shuma 1.562.877 lekë.
- Paga, shpërblime , pagesa leje e zakonshme dhe pagesa uniforme në Policinë e Shtetit për vitin 2017, si Drejtor i Përgjithshëm K&M dhe shef sektori në Drejtorinë e Studimeve Strategjike. Shuma 1.350.151 lekë.
- Paga, shpërblime, pagesa leje e zakonshme dhe pagesa uniforme në Policinë e Shtetit për vitin 2018, si Shef sektori në Drejtorinë e Studimeve Strategjike dhe nga maj 2018, Profesor në Akademinë e Sigurisë. Shuma 1.132.789 lekë.
- Paga, shpërblime , pagesa leje e zakonshme dhe pagesa uniforme në Policinë e Shtetit për vitin 2019 si, Profesor në Akademinë e Sigurisë. Shuma 1.082.962 lekë.
- Paga, shpërblime, pagesa leje e zakonshme dhe pagesa uniforme në Policinë e Shtetit për vitin 2020 si, Profesor në Akademinë e Sigurisë. Shuma 1.163.341lekë.
- Paga, shpërblime, pagesa leje e zakonshme dhe pagesa uniforme në Policinë e Shtetit për vitin 2021 si, Profesor në Akademinë e Sigurisë. Shuma 1.096.903 lekë.
- Paga, shpërblime, pagesa leje e zakonshme dhe pagesa uniforme në Policinë e Shtetit për vitin 2022 si, Profesor në Akademinë e Sigurisë dhe Drejtor Kabineti, si dhe një pagesë nga ANSIG si palë e dëmtuar. Shuma 1.231.144 lekë.

- Paga, dhe ndihmë në Policinë e Shtetit për vitin 2023 si Drejtor Kabineti (janar + mars 2023). Shuma 303.925 lekë.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD me nxjerrje llogarie në emër të Genc Merepeza, ku figurojnë kreditimi për paga, dieta, veshje, shërbime, etj., për periudhën maj 2005-mars 2023, në vlerën totale rreth 19.986.000 lekë. Për periudhën 2014-2017, konstatohet rimbursime për shpenzime telefoni në vlerën rreth 485.000 lekë.
- ✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot, datë 10.05.2023, konfirmon (paga bruto dhe neto) periudha kontributeve janar 2012-mars 2023, të Genc Merepeza pranë strukturave të Policisë së shtetit
- ✚ **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror,** me shkresën nr. *** prot., datë 17.05.2023, informon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave për periudhën 1994-2012, të punonjësve të siguruar në subjektet shtetëror juridik apo fizik, nuk mund të konfirmohet periudha kontributeve apo paga mbi të vilën janë siguruar në qoftë se nuk jepet dokumentacioni përkatës nga ana e subjektit kërkues lidhur me emërtimin e qendrës së punës, Nipt-in e subjektit, fotokopjen e librezës së punës, etj. Bashkëlidhur vërtetimi nr. *** prot. datë 15.5.2023, për vjetërsinë në punë për efekt pensioni të Genc Merepeza.

Trupa e vlerësimit nga analizimi i dokumentacionit të administruar dhe kryqëzimi i informacioni nëpërmjet relatorit të çështjes për nevoja të hetimit të gjithanshëm dhe të plotë, në komunikimin me email- it të datës 04.10.2023 i kërkoj subjektit të përcaktonte vlerën e pagesës së përfituar nga ANSIG.

Subjekti me email- in e datës 09.10.2023 sqaroi: “...në muajin tetor 2022, ne llogarinë time është hedhur shuma 69,600 ALL, e zhdëmtimit nga DEMI TPL – ANSIG”.

Konkluzion:

- ✓ Në lidhje me të ardhurat e subjektit, trupa e vlerësimit ka realizuar kryqëzimin e informacionit të vënë në dispozicion nga bankat e nivelit të dytë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore duke krijuar analizimin e të dhënave.
- ✓ Trupa e vlerësimit ka konfirmuar nëpërmjet nxjerrjes së llogarive bankare faktin se të ardhurat e sipërpërmendura kanë qenë kredite të pagës së subjektit të vlerësimit ndër vite.

V. DETYRIMET FINANCIARE

Subjekti vlerësues Genc Merepeza ka dhënë këto deklarime të detyrimeve në vite:

Detyrimi nr.1.

- Kartë krediti në Raiffeisen Bank, në shumën 1.500 euro me qëllim përdorim personal. Detyrimi i mbetur 522 euro.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Genc Merepeza, llogari për tërheqje master card, në vlerën 522 euro, datë 07.03.2023. Bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku figuron kartë kreditit me limit 1.500 euro.

Detyrimi nr.2.

- Kredi bankare për blerje apartamenti në ABI Bank, në shumën 30.000 euro, marrë në datë 21.03.2006 me afat deri më 21.03.2026. Detyrimi financiar i mbetur 9.324 euro.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **ABI Bank**. Me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon se Genc Merepeza ka marrë kredi hipotekore në shumën 30.000 euro, më datë 21.03.2006, kredi e cila është shlyer më datë 4.12.2020.
- Kredi hipotekore në shumën 14.717 euro, më datë 20.11.2020, kredi e cila më datë 07.03.2023 rezulton të jetë në shumën 9,638.
Merita Durmishaj rezulton si dorëzanëse në kredinë e marrë nga Genc Merepeza.

Në procesverbalin e datës 15.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: “...kredia e marrë në mars 2006, në shumën 30.000 euro. Si kolateral u la shtëpia e prindërve të bashkëshortes, deri në momentin kur do të dilte certifikata e pronësisë së apartamentit të blerë. Në vitin 2020 është bërë rialokimi i kredisë, duke u vendosur si kolateral apartamenti i blerë”.

Subjekti paraqet:

- Vërtetim Bankar nr. ***, datë 13.06.2023, ku jepen të dhëna për kredinë .

- Statement nga ABI Bank që vërteton se llogaria është ajo ku bëhet derdhja e këstit mujor të kredisë.

Gjatë hetimit administrative dhe kryqëzimit të të dhënave të administruara janë evidentuar derdhje në llogarinë e lëvrimit të kredisë pranë ABI Bank nga shtetasit: Q. B., R. Sh., S. H., M. M., D. Sh., F. Rr., L. R., F. L., L. R..

Në procesverbalin e datë 15.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: *“Lidhur me pagesat nga persona të tretë, sqaron se është një lehtësim që miqtë/të njohur i kanë bërë e i bëjnë, duke pasur parasysh që puna e subjektit është e lidhur dhe nuk lëviz dot gjatë orarit zyrtar”*.

Për sa më sipër në komunikimin me email-it të datës 04.10.2023 subjekti i vlerësimit, për nevoja të hetimit të gjithanshëm dhe të plotë, u pyet në lidhje me këtë konstatim.

Subjekti me email- in e datës 09.10.2023 sqaroi: *“Personat që kanë derdhur në llogarinë time, këstin mujor që ia kam dhënë unë, janë kolege dhe njerëz të njohur. Pamundësia për të kaluar nga banka për shkak të punës, kur nuk kam patur kohë, kam kërkuar nga këto persona, që të më bëjnë pagesën në llogarinë time.*

1. Z. Q. B. – shofer në Departamentin e Kufirit, është akoma dhe sot,
2. Z. R. SH. – ka qenë specialist në Departamentin e Kufirit, nuk është më në polici,
3. Z. SH. – punonjës policie dhe shofer në Departamentin e Kufirit, edhe në kohën që isha Drejtor, ishte shoferi i Drejtorit, sot në pension,
4. Z. M.M – ka qenë shofer në Departamentin e Kufirit, sot në pension,
5. Z. D. SH. – ka qenë Specialist në Departamentin e Kufirit, është akoma në polici,
6. Z. F. RR. – ka qenë Specialist në Departamentin e Kufirit, është akoma në polici,
7. Z. L. R. dhe Z. F.L., të njohur. Z. F.L (në pension) edhe sot e kësaj dite më bën pagesat tek ABI Bank, në pamundësi të lëviz nga puna, pasi kur e lëmë punën, banka është mbyllur. L.R mendoj se është po L.R, por është shkruar gabim emri, **jeton jashtë Shqipërisë.**

*Pagesat i kanë bërë në emrin tim sepse, ngarkesa e punës nuk më ka mundësuar që të shkoj në bankë për të bërë pagesat vete. Kur nuk kam patur kohë ia kam dhënë atyre që të më bëjnë pagesën. Mund të verifikohet që ABI Bank, nuk ka filiale afër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe afër Akademisë së Sigurisë. **Pagesa bëhet CASH, sepse nëse do behet në rrugë bankare, kursi i këmbimit të euros është më i disfavorshëm.** ”*

- ✚ **DPPSH**, me shkresën nr. *** prot. datë 10.11.2023 konfirmon faktin që Q. B., R. Sh., S. H., M. M., D. Sh., F. Rr., L. R., kanë qenë punonjës policie në periudhat që i kanë kryer derdhje të kësteve të kredisë në emër të subjektit.

Konkluzion:

- ✚ Nga kthim përgjigja e sipër përmendur e DPPSH-së si dhe dokumentacionit të administruar dhe sqarimet e paraqitura nga subjekti, konfirmohet fakti që këta punonjës në periudhat që kanë depozituar në llogari të subjektit, kanë mbajtur pozicione vartësie me subjektin vlerësimin, por pagesat janë kryer në kuadër të marrdhënieve shoqërore që mundën të kenë lindur në ambiente pune dhe jo për shkak të pozicionit të punës të subjektit të vlerësimit.

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur, Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

- Shpenzime për pagesën e detyrimit për energjinë elektrike me OSHE për vitin 2022. Kontrata nr. TR***. Shuma 82.555 lekë.
- Shpenzime për pagesën e detyrimit për ujë. UKT për vitin 2022. Zona **. Kontrata ***. Shuma 26.822 lekë.
- Pagesa për internet, telefon dhe akses në kanalet TV IPTV. Shuma 31.317 lekë.
- Telefon celular me ofertë 500 lekë/muaj =500 internet pa limit. Shuma 12.000 lekë.
- Telefon celular me parapagim . Shuma 12.000 lekë.
- Telefoni i bashkëshortes. Shuma 6.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

Kopje e librezës së pagesës së energjisë elektrike, Qendra ***, Nr. Kontrate ***, në emër të Genc Merepeza.

Kopje e librezës së pagesës së ujit, Zona ***, Nr. Kontrate ***, Tiranë, në emër të Genc Merepeza.

Kopje e librezës së pagesës së ALBTELEKOM, Nr. Tel. 042***, në emër të Genc Merepeza.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD me nxjerrje llogarie në emër të Genc Merepeza, ku figurojnë pagesat për vodafone gjatë periudhës janar-dhjetor 2022.

- ✚ **FSHU**, me shkresën nr. *** prot, datë 11.05.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Genc Merepeza, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet 1 (një) abonent me kontratë furnizimi nr. TR***, në instancën Tiranë. Bashkëlidhur detajet e pagesës për kontratën TR***, periudha janar-nëntor 2022, shuma 75.633 lekë. Me gjeneralitet Merita Durmishaj, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, nuk rezulton abonent apo kontratë e furnizimit me energji elektrike.

- ✚ **Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Tiranë**, me shkresën nr. ***prot, datë 24.05.2023, konfirmon se në emër të Genc Merepeza, rezulton kontrata nr. *** për objektin me adresë Rruga ***, në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrime të likuiduara deri në mars 2023. Bashkëlidhur: certifikatë për vërtetim pronësie ***, datë 29.03.2016, për apartamenti sip. 93.2m2, Rruga e ***, në emër të Genc Merepeza; pasqyra e pagesave për periudhën janar 2022-dhjetor 2022, shuma totale 28.857 lekë.

- ✚ **14 Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës- Kanalizime**, me shkresën *** prot, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjektet nga subjektet dhe peronat e lidhur me të.

- ✚ **Vodafone Albania** me shkresën nr.*** datë 14.07.2023, ka bashkëlidhur në formë elektronike informacionin ku konfirmohen shpenzimet e telefonisë celulare për Genc Merepeza gjatë vitit 2022, në shumën 12.841 lekë, dhe Merita Durmishaj, në shumën 5.568 lekë . Bashkëlidhur praktikës.

- ✚ **One Albania**, me shkresën nr. *** prot, datë 21.07.2023, konfirmon se në emër të Genc Merepeza, rezultojnë të regjistruar numër mobil 067*** dhe numër fiks 042***. Totali i faturave për numrin fiks nga datë 01.01.2022-31.12.2022, është 11.500 lekë. Merita Durmishaj nuk rezulton të ketë numër të regjistruar në shërbimin e telefonisë mobile, telefonisë fikse/internet në rrjetin One.

Në procesverbalin e datë 15.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit dhe 21.06.2023 subjekti ka sqaruar: “...lidhur me pagesën e internet, telefon dhe akses në kanalet e TV IPTV, shuma 31.317 lekë të deklaruar subjekti në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI më datë 15.06.2023 dhe 21.06.2023 sqaron se ka kontratë me Albtelcom ku paguhet telefon, internet dhe IPTV me një tarifë pothuajse fikse mujore prej rreth 2.000 lekë/muaj. Për telefonin Albtelcom me nr. 067***, ka bërë pagesë 1000 lekë/muaj me parapagim. Lidhur me shpenzimet telefonike të subjektit në vlerat e deklaruar 12.000 lekë, nr. 06941***, nga Vodafone Albania, është bërë një tarifë fikse, 500 lekë në muaj, por duke pasur parasysh që pjesën më të madhe të kohës ka punuar pedagog në Akademinë e Sigurisë dhe e kishte të nevojshme të konsumonte internetin për përgatitjen e leksionit, ka aktivizuar internet pa limit në shumën 500 lekë. Pagesa bëhej nëpërmjet bankës nga paga.

Lidhur me shpenzimet e telefonit të bashkëshortes në shumën 6.00 lek, subjekti sqaron se Vodafone Albania ka bërë një ofertë që një nr. 06941..., mundet të fus në grupin e tij familjarë, kundrejt vlerës 500 lekë/muaj. Nëpërmjet komunikimit me Vodafone, nuk u është mundësuar informacioni i pagesave vjetore, por ka vetëm një pagesë mujore në vlerën 505 lekë, e cila tregon se në këtë vlerë është çdo muaj”.

Subjekti paraqiti:

- Kopje të librezës së pagesave të dritave me nr. kontrate ***, ku pagesa për muajin dhjetor 2020, është në shumën 9.094 lekë.
- Kopje e librezës së pagesave për numrin e telefonit 042****, për periudhën janar- dhjetor 2022.
- Mandat Arkëtimi datë 01.05.2023, në emër të Merita Durmishaj, për llogari të Vodafone.

Konkluzion:

- ✓ Nga verifikimet e kryera dhe dokumentacioni i administruar deklarimi i subjektit konfirmohet me përgjigjen e Raiffeisen Bank. FSHU, UKT.
- ✓ Shpenzimet për ujë + drita+ telefon + internet, gjatë periudhës së sipër cituar, me kontrata në emër të subjektit dhe parapagesë në emër të bashkëshortes, rezultojnë në total rreth 160.000 lekë.

TË DHËNA KONFIDENCIALE

1. Apartament banimi me sip.99 m2, nga të cilat 93.2 m2, është sipërfaqe banimi dhe pjesa tjetër është sipërfaqe e përbashkët në adresën “Rruga e ****”, Njësia nr.*** Ndërtesa nr. ***, hyrja nr.*** Tiranë . Blerë në vitin 2005 dhe hipotekuar në vitin 2016. Certifikatë nr. ***, datë 29.03.2016 nr.pasurie:***, Zona Kadastrale ***. Volumi: ***,Faqe:***.
2. Automjet KIA, model Sportage me targa AA **** RL, vit prodhimi 2005. Kontratë shitblerje nr. rep.***, nr., kol. ***, datë 04.05.2017.
3. Poseduesi i 20% të sip. së tokës prej 10.000 m2 në fshatin Pezë e Vogël, Tiranë. Certifikatë nr. ***, datë 17.01.2011. Nr. i pasurisë ***.
4. Poseduesi i 20% të sip. tokës prej 1.250 në fshatin Pezë e Vogël, Tiranë. certifikatë nr. ****, datë 17.01.2011. nr. i pasurisë ***.
5. Poseduesi i 20% të sip. së tokës prej 878m2 në fshatin Pezë e Vogël, Tiranë. certifikatë nr.***, datë 17.01.2011. Nr. i pasurisë ***.

6. Llogari individuale nr.****, data e balancës 03.03.2023. Vlera 82.632 lekë.

Trajtuar më sipër.

- Llogari bankare në Raiffeisen Bank në euro, hapur më datë 03.06.2007, pagesat për një aktivitet në Kosovë. Vlera 0 euro.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Genc Merepeza, llogari në vlerën 0 euro, datë 07.03.2023.
- Llogari bankare në Paund Britanik, në Raiffeisen Bank, me nr. ***, hapur në vitin 2009, vetëm për një transaksion në interes të kumatës, e cila jetonte në Angli. Burimi i krijimit të ardhurat nga dyqani i saj në Rr. “*****”. Mbyllur më datë 13.4.2018. Vlera 0 paund.

Bashkëlidhur deklaratës:

Nxjerrje llogarie datë 13.04.2018, për llogari në vlerën 0 GBP, në emër të Genc Merepeza. Në datë 07.05.2009, figuron kreditimi i shumës 5.030 GBP si depozitim në llogari, shumë e cila është transferuar në po të njëjtën datë (5.015 GBP).

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Genc Merepeza, llogari në vlerën 0 GBP, datë 07.05.2009, si depozitim në llogari, nga e cila shuma 5.01 GBP është transferuar në po të njëjtën datë në llogari të shtetases N.P në shtetin anglez.

Në procesverbalin e datë 15.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: “...llogaria është hapur për të dërguar një shumë prej 5.000 paund, motrës së bashkëshortes e cila jeton në Londër. Shuma është tërhequr paraprakisht nga llogaria në euro pranë RFB në emër të N.P, nga nënë e bashkëshortes, Dh.D, e cila ka patur të drejtë të kryej veprime në llogari bashkë me të bijën (Nevila).

*N.P dhe A.P kanë disa ambiente tregtarë në Rr. ****, të cilat i kanë lënë me qira deri aktualisht. Janë mundësuar vetëm kontratat koherente të qirave, të cilat kanë vijuar ndër vite. vlerat e qirave mujore depozitoheshin cash në bankë nga Dh.D, pasi i kishte marrë paraprakisht nga qiramarrësi.*

Shuma, pasi u depozitua në llogarinë e subjektit, u konvertua në Paund Britanik dhe u nis në dispozicion me komision banke 15 paund.

Subjekti paraqiti:

- Statement nga Raiffeisen Bank, datë 09.06.2003 për periudhën 23.08.2007-09.06.2023, në emër të N.P, monedha euro ku figurojnë depozitime cash, si dhe në datë 07.05.2009, tërheqja e shumës 5.900 euro.
- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.04.2021, ku A,P dhe N.P japin me qira tek E.K- Person Fizik me NIPT L***R, pasurinë “njësi” me sip. 70.6 m2 + 75m2, ndodhur në Rr. “****”, Tiranë. Shuma mujore e qirasë 1.700euro/ bruto neto 1.572 euro (diferenca do të mbahet tatim fitim). Afati 5 vjeçar.
- Kontratë qiraje nr., 8390 rep., nr. 4390 ko., datë 1.11.2022, ku A.P dhe N.P japin me qira tek Xh. B, pasurinë me sip. 40 m2, ndodhur në Rr. “*****”, Tiranë. Shuma mujore e qirasë 800 euro (diferenca do të mbahet tatim fitim). Afati 5 vjeçar.

Në lidhje me krijimin e kësaj pasurie trupa e vlerësimit ka realizuar kryqëzimin e informacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i vlerësimit dhe bankat e nivelit të dytë.

Nga verifikimi ka rezultuar se kontratat e qirasë të paraqitura nga subjekti i vlerësimit janë të vitit 2020 dhe 2021, dhe nuk vërtetojnë të ardhurat e personit tjetër të lidhur për periudhën (07.05.2009) kur është kryer transferta bankare nga nëna e zonjës N.P në llogari të subjektit .

Për nevoja të hetimit të gjithanshëm dhe të plotë relatori, **në komunikimin me email të datës 4.10.2023**, i ka kërkuar subjekti të vinte në dispozicion të Trupës së Vlerësimit dokumentacionin justifikues. (kontrata qiraje të periudhës respektive ose certifikatë pronësie të ambienteve të dhëna me qira).

Subjekti me email- in e **datës 09.10.2023** sqaroi: *“Pasi nuk janë ruajtur dokumentet. Kontrata është bere ndërmjet palëve. Kam vene ne dispozicion, Certifikatën e pronësisë se motrës së bashkëshortes N.P, kontrata aktuale dhe te dhëna bankare qe është bere transaksioni ne banke ne atë kohe.*

Largimi nga Shqipëria është i pamundur te vërtetohet me dokumente sepse është larguar ne vitin 1994-1995, ne kohen kur evidentimi behej me regjistra (regjistrat ruhen 10 vjet).”

Gjithashtu **në komunikimin me email të datës 03.11.2023** ku subjekti, ju kërkuar të vinte në dispozicion të Trupës së Vlerësimit dokumentacionin justifikues për burimin e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur znj. N.P.

Subjekti me email- in e datës **06.11.2023** sqaroj: "...znj. N.P, bashkë me bashkëshortin A.P, shtëpinë (në katin e parë) në Rrugën "****" dhe shtesën e bërë në vitet 2000, e kanë kthyer në ambient shërbimi. Gjatë gjithë kohës ata e kanë dhënë me qira. Kontratat e para nuk i kanë ruajtur, sepse e kanë bërë edhe në mirëbesim. Vitet e fundit i kanë kontratat, të cilat janë në dosje.

Gjatë qëndrimit në Angli, motra e bashkëshortes, ka patur emrin **Sh. Gj**, e datëlindjes, 20(21).09.1969...

Subjekti paraqiti:

- **Old Statement të Raiffeisen Bank.** Në këtë llogari kanë patur akses, si N.P ashtu dhe e ëma Dh.D . Të ardhurat nga qeraja, i paguheshin në dorë dhe arkëtoheshin nga e ëma, Dh.D . Koha e qëndrimit në Angli e N.P është nga viti 1994 deri 2021. Vit që u kthyen në Shqipëri familjarisht.

Konkluzion:

- ✓ Nga kryqëzimi i dokumentacionit të administruar si dhe i sqarimeve të paraqitura nga subjekti i vlerësimit, Llogaria bankare në Paund Britanik në Raiffeisen Bank është hapur në vitin 2009 dhe është kryer vetëm transaksioni kreditim/ debitim në shumën 5.000 GBP. Burimi i kësaj shume janë deklaruar të ardhurat nga qiradhënia e pasurive të paluajtshme të kumatës së subjektit dhe bashkëshortit të saj (të cilët prej vitesh jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar),
 - ✓ Llogaria është hapur më datë 07.05.2009. Prej datë 21.05.2009, nuk janë kryer veprime në llogari aktualisht është më gjendje 0GBP.
 - ✓ Marrëdhënia e subjektit të vlerësimit me shtetasen N.P trajtuar dhe në kuadër të kontrollit të figurës (Më poshtë).
- Overdraft në Raiffeisen Bank, në shumën 15.000 lekë, viti 2005. Miratuar në vitin 2014. Vlera 0 lekë.
 - Overdraft në Raiffeisen Bank, në shumën 90.000 lekë, viti 2020. Miratuar në vitin 2020. Vlera 0 lekë.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, nuk konfirmon overdraftet në vlerën 15.000 lekë, marrë 2005 dhe 90.000 lekë. Marrë në vitin 2020.

Subjekti paraqiti:

- Vërtetimi nr. ***, datë 12.06.2023 nga Raiffeisen Bank, sipas të cilës Genc Merepeza ka marrë dy linja overdrafti në vlerë 15.000 çelur më datë 25.11.2005 dhe mbyllur më datë 01.01.2020 dhe linja në shumën 90.000 lekë më datë 20.01.2020 dhe mbyllur më datë 12.10.2020.

Konkluzion:

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Genc Merepeza, overdraftet.

DEKLARIM I BASHKËSHORTESSË SUBJEKTIT MERITA DURMISHAJ **DEKLARIMI I PASURIVE**

Pasuria nr. 1.

- Gjendje cash në banesë . Vlera 15.000 lekë. Pjesa takuese 100%.
Burimi i krijimit: Kursime nga paga.

Konkluzion:

- ✓ Trupa e vlerësimit, referuar hetimit financiar të kryer, ka konstatuar se subjekti i vlerësimit ka të ardhurat të mjaftueshme për krijimin e gjendjes cash të deklaruar.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Instituti i Projekttimeve Tiranë. Nuk ka informacion.
- Ndërmarrja e Boksive Tiranë deri në vitin 1991. Nuk ka informacion.
- Kohë papunësie 1991-1995. Vlera 0 lekë.
- Të ardhura nga paga në Ministrinë e Brendshme 1995-mars 1998. Nuk ka informacion. Në mars 1998 është krijuar familja e Genc Merepeza dhe Merita Durmishaj.

- Të ardhura nga puna në emigracion, Verona Itali, periudha 1.4.1998- 30.9.2002. Shuma 51.600 euro.
- Likuidacion i shkëputjes së marrëdhënieve të punës (në momentin e largimit, të punësuarit i kthehen kontributet). Shuma 4.800 euro.
- Nga viti 2003-2004 nuk ka qenë e punësuar. Vlera 0
- Të ardhura nga paga në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe në Ministrinë e Arsimit, për periudhën, nga viti 2005. Shuma 296.158 lekë.
- Paga, shpërblime, honorarë, nga puna si asistente e Zv/Ministrit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, viti 2006. Shuma 390.090 lekë.
- Paga, shpërblime, honorarë, nga puna si asistente e Zv/Ministrit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, viti 2007. Kredi konsumatorë e marrë në Raiffeisen bank, vitin 2017. Shuma 1.508.743 lekë.
- Paga, shpërblime, honorarë, nga puna si asistente e Zv/Ministrit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, viti 2008. Shuma 496.980 lekë.
- Paga, shpërblime, honorarë, nga puna si asistente e Zv/Ministrit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, viti 2009. Shuma 475.847 lekë.
- Paga, shpërblime, honorarë, nga puna si asistente e Zv/Ministrit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, viti 2010. Shuma 498.448 lekë.
- Paga, shpërblime, honorarë, nga puna si asistente e Zv/Ministrit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, viti 2011. Shuma 558.897 lekë.
- Paga, shpërblime, honorarë, nga puna si asistente e Zv/Ministrit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, viti 2012. Shuma 541.376 lekë.
- Paga, shpërblime, honorarë, nga puna si asistente e Zv/Ministrit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, viti 2013 dhe kredi konsumatorë e marrë në Raiffeisen bank 2013. Shuma 1.566.571 lekë.
- Paga, shpërblime, honorarë, nga puna si asistente e Zv/Ministrit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, viti 2014. Shuma 602.398 lekë.
- Paga, shpërblime, honorarë, nga puna si asistente e Zv/Ministrit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, viti 2015. Shuma 654.140 lekë.
- Paga, shpërblime, honorarë, nga puna si asistente e Zv/Ministrit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, viti 2016, dhe pagesa për heqjen dorë nga apartamenti i prindërve nga motra, Nevila Zhan Pregapuca. Deklaratë noteriale rep.nr.247., kol. 31, datë 12.01.2013. Shuma 1.620.247 lekë.
- Paga, shpërblime, honorarë, nga puna si asistente e Zv/Ministrit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, viti 2017. Shuma 629.906 lekë.
- Paga, shpërblime, honorarë, nga puna si asistente e Zv/Ministrit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, viti 2018. Shuma 137.172 lekë.
- Paga dhe shpërblime nga puna në Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, janar 2022-31.12.2022. Shuma 800.992 lekë

- Paga dhe shpërblime nga puna në Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, janar 2023-mars 2023. Shuma 201.342 lekë

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. ***prot, datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD me nxjerrje llogarie në emër të Merita Durmishaj, ku figurojnë kreditime për paga, honorarë, shpërblime, etj. Për periudhën mars 2005-mars 2023, në vlerën totale rreth 7.944.000 lekë.
- ✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot, datë 10.05.2023, konfirmon (paga bruto dhe neto) periudha kontributeve shkurt 2012-mars 2023, të Merita Durmishaj pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe IKMT.
- ✚ **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror**, me shkresën nr. *** prot. Datë 17.05.2023 informon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave për periudhën 1994-2012, të punonjësve të siguruar në subjektet shtetëror juridik apo fizik, nuk mund të konfirmohet periudha kontributeve apo paga mbi të vilën janë siguruar në qoftë se nuk jepet dokumentacioni përkatës nga ana e subjektit kërkues lidhur me emërtimin e qendrës së punës, Nipt-in e subjektit, fotokopjen e librezës së punës, etj. Bashkëlidhur vërtetimi nr. 4745 prot. datë 15.05.2023, për vjetërsinë në punë për efekt pensioni të Merita Durmishaj, qendra e punës ISP Nr.4, Tiranë, data e fillimit 01.12.1982, data e largimit 31.12.1998.

Konkluzion:

- ✓ Të ardhurat e bashkëshortes nga paga, shërbime, honorarë, etj., për periudhën mars 2005-mars 2013, konfirmohen nga sistemi bankar në shumën 7.944.00 lekë.
- ✓ Të ardhura nga puna në emigracion dhe likuidacioni shkëputjes së marrëdhënieve të punësimit në Itali, për periudhën 1998-2002, janë deklaruar në shumë totale 56.400 euro. Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka dokumentuar hyrjen e bashkëshortes në Itali më datë 24.3.1998, si dhe qëndrimin e punësimin e saj prej datë 29.5.1998.(trajtuar më sipër)
- ✓ Të ardhura në shumën 1.000.000 lekë, në formë pagese nga motra, N.P, për heqjen dorë nga apartamenti i prindërve.
- ✓ Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, trupa e vlerësimit ka realizuar kryqëzimin e informacionit të vënë në dispozicion nga bankat e nivelit të dytë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore duke krijuar analizimin e të dhënave.

- ✓ Trupa e vlerësimit ka konfirmuar nëpërmjet nxjerrjes së llogarive bankare faktin se të ardhurat e sipërpërmendura kanë qenë kreditime të pagës së subjektit të vlerësimit ndër vite.
- Llogari në Raiffeisen Bank nr. ***. Data e balancës 6.3.2023. Vlera 58.651 lekë

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Merita Durmishaj llogari page në vlerën 58.551 lekë, datë 07.03.2023.

DETYRIMET FINANCIARE

Detyrimi nr.1.

- Kredi konsumatorë prej 1.000.000 lekë, marrë ne Raiffeisen Bank më datë 18.06.2007 me afat 10 vjeçar. Mbyllur me ripërtëritjen e kredisë konsumatorë 1.000.000 lekë, marrë me datë 25.10.2013. Detyrimi i mbetur 0 lekë.
- Ripërtëritje e kredisë konsumatorë prej 1.000.000 lekë, marrë në Raiffeisen Bank më datë 25.10.2013, me afat 10 vjeçar. Qëllimi i pagesa e kësti të fundit të apartamentit të banimit para marrjes së certifikatës së pronësisë. Likuiduar më 12.12.2016, pas marrjes së vlerës 1.000.000 lekë sipas deklaratës noteriale “ Heqje dorë nga apartamenti i prindërve kundjet shumës 1.000.000 lekë”, në interes të motrës së saj , N.P. Detyrimi i mbetur 0 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

Deklaratë noteriale nr. rep. *** nr. kol. ***, datë 12.1.2013, sipas të cilës Merita Durmishaj ka një shumë parash cash prej 1.000.000 lekë, prej nënës së saj, Dh. D , nga tjetërsimi i ½ pjesë të barabartë të pasurisë me nr. ***, ZK ***, vol.***, fq.***, lloji apartament me sip. 63m2, Rruga “*****”, Tirane., Gjithashtu, deklaron e me vullnetin e saj të lirë, heq dorë në mënyrë të përvokueshme në lidhje në lidhje me këtë pasuri dhe pas nënshkrimit të deklaratës, nuk ka asnjë pretendim pasuror ose financiar mbi të, si dhe është dakord që kjo pasuri të tjetërsohet në emër të motrës. N.P.(Durmishaj).

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD me nxjerrje llogarie në emër të Merita Durmishaj, ku figurojnë kredi në vlerën 1.000.000 lekë, datë 18.6.2007, kredi në vlerën 999.432 lekë, datë 25.10.2013, shlyer në vlerën 573.174 lekë, datë 12.12.2016.

Në procesverbalin e **datës 15.06.2023** të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit subjekti ka sqaruar: “...ndonëse deklarata noteriale është bërë më datë 12.01.2013 dhe në të shprehet se bashkëshortja ka shumën 1.000.000 lekë, por në këtë kohë e motra do të kthehej nga Anglia dhe u la në mirëkuptim që pagesa do të bëhej në një kohë tjetër. E vërteta është se me marrjen e kësaj shume, u mbyll kredia konsumatorë në Raiffeisen Bank.

Bashkëshortja hoqi dorë nga apartamenti për të çuar në vend një amanet të prindërve të saj, që banesa të ishte e vazhës së vogël. Kjo u zgjidh në mirëkuptim ndërmjet motrave, në këtë periudhë jetonte vetëm nëna e bashkëshortes sepse i ati kishte ndërruar jetë. Kjo pagesë është bërë në vitin 2015. Burimi i krijimit të shumës 1.000.000 lekë nga Nevila, janë të ardhurat nga qiradhënia e pasurive të saj.

Subjekti ka paraqitur:

Deklaratë datë 13.06.2023 nga N.P(Durmishaj), sipas të cilës shumën 1.000.000 lekë ia ka dhënë motrës së saj, Merita Durmishaj, në vitin 2015, me vullnet të lirë dhe mirëkuptim ndërmjet motrave, për pjesën që i takon nga shtëpia e prindërve, të cilën aktualisht e ka në pronësi.

Trupa e vlerësimit për nevoja të hetimit të gjithanshëm dhe të plotë në komunikimin **me email të datës 4.10.2023 dhe emailt të datës 03.11.2023** subjekti, ju kërkua të vinte në dispozicion të Trupës së Vlerësimit dokumentacionin justifikues për burimin e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur znj. N.P.

Subjekti me **email- in e datës 06.11.2023** sqaroi: “...znj. N.P , bashke me bashkëshortin A.P, shtëpinë (në katin e parë) në Rrugën “***” dhe shtesën e bërë në vitet 2000, e kanë kthyer në ambient shërbimi. Gjatë gjithë kohës ata e kanë dhënë me qira. Kontratat e para nuk i kanë ruajtur, sepse e kanë bërë edhe në mirëbesim. Vitet e fundit i kanë kontratat, të cilat janë në dosje.

Subjekti paraqiti:

- **Old Statement të Raiffheisen Bank.** Në këtë llogari kanë patur akses, si N.P ashtu dhe e ëma Dh.D . Të ardhurat nga qiraja, i paguheshin në dorë dhe arkëtoheshin nga e ëma, Dh.D .

Konkluzion:

- ✓ Kredia konsumatorë në shumën 1.000.000 lekë, është marrë në vitin 2007, ristrukturuar në vitin 2013 dhe shlyer totalisht në vitin 2016, me burim heqjen dorë nga apartamenti i prindërve kundrejt shumës 1.000.000 lekë, në interes të së motrës, N.P, e cila aktualisht e ka në pronësi apartamentin.
- ✓ Trupa e vlerësimit nga kryqëzimi i dokumentacionit të administruar dhe sqarimeve të paraqitura nga subjekti i vlerësimit rezulton se sipas Deklaratës noteriale nr. rep.***, nr. kol. ***, datë 12.01.2013, Mertita Durmishi ka marrë shumë parash cash prej 1.000.000 lekë nga mamaja e saj Dh. D., ndërsa në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në datë 13.06.2023 (deklaratë me shkrim dore) rezulton se kjo vlerë është paguar nga N.P (motra e bashkëshortes).

TË DHËNA KONFIDENCIALE

- Heqje dorë nga apartamenti i prindërve kundrejt shumës 1.000.000 lekë, në interes të motrës së saj , N.P. Deklarate noteriale nr. rep. ***, nr. kol. **, datë 12.01.2013.

Trajtuar më sipër.

- Llogari bankare për pagat në Raiffeisen Bank, më date 06.03.2023, në vlerën 58.651 lekë. Nr. llogarie *** ALL.

Trajtuar më sipër.

Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përbaluara - Periudha 01.01.2020 — 31.12.2022.

Udhëtim në Itali, Romë. Takim zyrtar nga datë 21-23 janar 2023. Delegacion. Shuma 424 euro, mbuluar nga EU4LEA.

Bashkëlidhur deklaratës:

Shkresa nr. * prot., datë 27.02.2023**, “Kthim përgjigje” nga Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, e cila ka bashkëlidhur listën e hyrje daljeve nga Republika e Shqipërisë për periudhën 01.01.2020 deri më datë 27.02.2023, ku figuron udhëtimi në Romë me Eïzz Air, datë 22..2023-24.1.2023.


Shkresa nr. ex* prot., datë 27.02.2023**, “Kthim përgjigje” nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, sipas të cilës Merita Durmishaj nuk ka realizuar hyrje- dalje nga Republika e Shqipërisë për periudhën e kërkuar.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

Trupa e vlerësimit gjatë analizimit të dokumentacionit të administruar dhe kryqëzimin të informacionit të përfituar, për nevoja të hetimit të gjithanshëm dhe të plotë në komunikimin me email të datës 04.10.2023 subjekti ju kërkua të vinte në dispozicion të Trupës së Vlerësimit dokumentacionin justifikues që vërteton faktin.

Subjekti ka sqaruar: “Udhëtimi u sponsorizua nga EU4LEA për një pjese te delegacionit. Dorëzimi na është bere CASH, ne zyrën time, nga përfaqësuesja e financës se EU4LEA.

Subjekti paraqiti:

 *Genc Merepeza_perdiem Pagesa për Itali EU4LEA.*

Konkluzion:

- ✓ Nga dokumentacioni i administruara nga Trupa e Vlerësimit, si dhe nga deklaratimet e sjella nga vete subjekti, nuk rezultojnë shpenzime për udhëtimi për arsye private.

Në mënyrë të përmbledhur, referuar të dhënave të deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti dhe bashkëshortja kanë deklaruar deri në datë 7.03.2023, si më poshtë:
1. Apartament banimi me sip. 99m ² , Rruga e Dibrës, Tiranë. Vlera 69.300 euro Subjekti zotëron me bashkëshorten 100%
2. Tokë arë sip. 878m ² , Përzë e Vogël, përfituar me Ligjin 7501. Subjekti zotëron 20%.
3. Tokë arë sip. 1250m ² , Përzë e Vogël, përfituar me Ligjin 7501. Subjekti zotëron 20%.
4. Tokë arë sip. 10.000m ² , Përzë e Vogël, përfituar me Ligjin 7501. Subjekti zotëron 20%.
5. Automjet KIA me targa AA443RL. Vlera 500.000 lekë. Subjekti zotëron 100%.
6. Gjendje cash në banesë . Vlera 10.000 lekë. Subjekti zotëron 100%.
7. Llogari bankare në Raiffeisen Bank. Vlera 82.632 lekë. Subjekti zotëron 100%.
8. Llogari bankare në Raiffeisen Bank. 0 euro. Subjekti zotëron 100%.
9. Llogari bankare në Raiffeisen Bank. Vlera 0 paund. Subjekti zotëron 100%.
10. Gjendje cash në banesë . Vlera 15.000 lekë. Bashkëshortja e Subjekti zotëron 100%.

11. Llogari bankare në Raiffeisen Bank. Vlera 58.651 lekë. . Bashkëshortja e Subjekti zotëron 100%.
12. Kartë krediti në Raiffeisen Bank, në shumën 1.500 euro. Detyrimi i mbetur 522 euro. Subjekti zotëron 100%.
13. Kredi bankare në ABI Bank, në shumën 30.000 euro. Detyrimi i mbetur 9.324 euro.
<u>Vlera e pasurisë bruto është 69.300 euro +666.283 lekë, e konvertuar rreth 8.618.000 lekë</u>
<u>: Subjekti ka detyrim për kredi në ABI Bank, në vlerën 9.324 euro, e konvertuar rreth 1.070.000 lekë</u>
<i>(Konvertuar me kursin e këmbimit të BSH të datës 07.03.2023, ku 1 euro = 114.75 lekë.)</i>

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **Banka e Shqipërisë, Banka Kombëtare Tregtare, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka Procredit, Banka e Parë e Investimeve, Banka Credins, Banka Union, Banka OTP Albania, Raiffesien Bank, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landesleasing, RFZ Invest, Credins Invest, Ak Invest, Fondi Besa, Institucioni Financiar Noa, Iutecredit Albania, Kredo Financë, Albania Satellite Communications, Abissnet, Digicom,** konfirmojnë se subjekti dhe bashkëshortja nuk janë klientë të tyre, çka përputhet me deklarimin.
- ✚ **ASHK, Drejtoritë dhe Zyra Vendore, Tiranë Jug, Tiranë Veri, Tirana Rurale 1, Zonat e Stimuluara, Kamzë Vorë, Berat, Fier, Librazhd, Mallakastër, Devoll, Korçë, Lezhë, Lushnjë, Krujë, Kuçovë, Gjirokastër, Tirana Jug, Malësi e Madhe Kukës, Kavajë, Bulqizë, Skrapar, Kolonjë, Elbasan, Peqin, Tropojë, Tepelenë, Përmet, Mirditë, Sarandë, Dibër, Pogradec, Vlorë, Dibër, Shkodër, Kurbin,** nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në procese legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.
- ✚ **Intesa Sanpaolo Bank,** me shkresën nr. ***, datë 12.05.2023, konfirmon se Genc Merepeza identifikohet me nr. ***(base number). Bashkëlidhur lista e transaksioneve për përudhen 2016-2017, tërheqje cek datë , 07.03.2016, shuma 137 euro, datë 01.03.2017, shuma 184 euro, datë 01.03.2017, 235 USD, datë 07.04.2017, shuma 284 euro dhe datë 07.06.2017, shuma 74 euro,

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

Në procesverbalin e datë 15.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: “...se gjatë periudhës kur janë kryer transaksionet e mësipërme, ka qenë me detyrë në Drejtorinë e Përgjithshme të Kufi dhe Migracionit. Si natyrë pune kishte lidhje me IOM dhe UNHCR dhe kanë pasur shumë aktivitete brenda dhe jashtë vendit. Pagesa nga këto organizata bëhej nëpërmjet bakës. Veprimet bankare kanë qenë vetëm dorëzim ceku dhe tërheqje parash”.

✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 12.05.2023, konfirmon se Genc Merepeza ka patur llogari aktive me nr. ***, ne monedhën leke, për periudhën 2010 - 2013. Në datën e kërkuar, nuk ka patur marrëdhënie pranë bankës.

✚ **ABI Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon se Genc Merepeza ka llogari rrjedhëse në euro (kredi) ne vlerën 15.194 euro.

ABI Bank, me postën elektronike datë 27.06.2023, konfirmon se shuma prej 15.194 është ekuivalenti ne leke i shumes 132.41 euro. Bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku gjendja me datë 7.3.2023, është në vlerën 132.41 euro.

Në procesverbalin e datë 15.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka sqarua: “në ABI Bank ka marrë kredinë e deklaruar dhe nuk ka asnjë llogari rrjedhëse në shumën 15.194 euro”.

Subjekti ka paraqitur:

- Statement bankar nga ABI Bank, periudha 13.01.2023 - 22.05.2023, ku gjendja e llogarisë me datë 22.02.2023, ka qenë 132 euro.

✚ **Unioni Financiar i Tiranës**, me shkresën nr. *** prot, datë 09.05.2023, konfirmon se për periudhën 27.04.2018 - 07.03.2023:

- Genc Merepeza, ka tërhequr 100 euro dhe ka dërguar 187 euro.
- Merita Durmishaj, ka tërhequr 400 euro dhe ka dërguar 97.150 lekë.

Në procesverbalin e datë 15.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit subjekti ka sqarua: “...tranferrat lidhen me të afërmit e tyre jashtë shtetit dhe konkretisht, motrën e subjektit. Shtetësia S.L (Merepeza), e cila jeton në Genova, Itali. Kanë marrë dhe dërguar para për blerje të ndryshme, por edhe dërgimin e prodhimeve shqiptare që kanë kosto blerje dhe transporti.

✚ **Easypay**, me shkresën nr. *** prot, datë 12.5.2023, konfirmon se Genc Merepeza është i regjistruar si klient i parasë elektronike prej datë 12.03.2019, por nuk rezulton te ketë kryer transaksione.

- ✚ **QKB**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon se Genc Merepeza dhe personat e lidhur nuk figurojnë të jenë të pajisur me NUIS (NIPT) si persona fizikë apo të zotërojnë kuota/aksione ne shoqëri tregtare te regjistruara pranë regjistrit tregtar.
- ✚ **DPT**, me shkresën nr. *** prot, datë 12.05.2023, konfirmon se Genc Merepeza dhe personat e lidhur nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim te ndonjë aktiviteti privat.
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën nr. *** prot, datë 10.05.2023, nuk konfirmon mjet lundrues ne pronësi te Genc Merepeza dhe Merita Durmishaj.
- ✚ **Ministria e Drejtësisë (Regjistri noterial)**, me shkresën nr. *** prot, datë 18.09.2023, konfirmon veprimet noteriale të deklaruara nga subjekti i vlerësimit.
- ✚ Gjatë hetimit administrativ të kryer rezulton se subjekti i vlerësimit ndër vite ka deklaruar pranë ILDKPKI-së, shtëpi private me sip. 85m2, trashëguar nga prindërit, në Pezë e Vigël.

Në procesverbalin e datë 15.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administrimi nga trupa e vlerësimit subjekti ka sqarua: “... ndër vite, ka deklaruar shtëpi private me sip. 85m2, trashëguar nga prindërit, ne Pezë e Vogël. Atëherë e ka deklaruar veten pjesëtar, duke pasur parasysh aktet e trashëgimisë. Por me pas, së bashku me motrat, vendosën që këtë shtëpi t'ia dhuroni vëllait, menqënesë ai ka banuar gjithmonë aty dhe është kontributori kryesor. Subjekti personalisht ka hequr dore nga kjo shtëpi, duke ruajtur të drejtat në pjesën takuese të pasurive të paluajtshme toke are, të deklaruara”.

Subjekti ka paraqitur:

- Deklarate Noteriale nr.***, datë 15.06.2023, për heqje dore nga pronësia apo bashkëpronësia, sipas se cilës Genc Merepeza deklaroi se është bashkëpronar i një shtëpie banimi 1 kat në Pezë e Vogël, sipas listës së trojeve ne ZK ***, fakt që vërtetohet nga vërtetimi lëshuar me datë 14.06.2023, nga Bashkia Tirane, Njësia Administrative Pezë. Gjithashtu, deklaroi se heq dore në mënyre të përvokueshme, nga pjesa takuese në pasurinë shtëpi banimi dhe se nuk ka asnjë pretendim pasuror apo financiar mbi të
- Vërtetim datë 14.06.2023, nga Njësia Administrative Peze, sipas së cilit E.M, B.M , kanë një shtëpi banimi ne Peze te Vogël, sipas listës së trojeve ne ZK ***.Trashëgimtarët janë: F.M., Genc Merepeza, A.M, V.L dhe S.L. Shtëpia është 1 kat dhe është ndërtuar para vitit 1991. Ne këtë shtëpi aktualisht banon F.M dhe familja e tij.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

✚ ASHK, Drejtoria Vendore Tirane Rurale 2, me shkresën nr. *** prot, datë 07.07.2023, nuk e konfirmon pasurinë e paluajtshme ne emër të Genc Merepeza.

Konkluzion:

- ✓ Subjekti i vlerësimit nuk ka deklaruar shtëpi banimi 85m2 edhe pse në momentin e plotësimit të formularit për vlerësimin e pasurisë ka pasur detyrimin ta deklaroj, referuar nenit 33 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- ✓ Kjo psauri është e trashëguar nga prindërit.

✓ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

- **Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- **Nuk është kryer deklarim i rremë;**
- **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit**

B. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërmra (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

✚ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit z. **Genc Elez Merepeza** me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë së deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, për vlerësimin e kontrollit të figurës ka dorëzuar nëpërmjet shkresës Nr.*** datë 20.07.2023 raportin e kontrollit të figurës² ku ka konstatuar se:

✚ **Subjekti i vlerësimit z.Genci Eles Merepeza, me detyrë Drejtor Kabineti, në Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka patur apo ka regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka pasur apo ka shtetësi tjetër.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.

² Raporti mbi kontrollin e figurës nr.***** datë 20.07.2023

- Nuk ka është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë ndaj tij masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar
- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.

Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vetdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit

për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e vlerësimit konstatoi se:

1. **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**, me shkresën nr.***. Prot, datë 05.06.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Genc Elez Merepeza, bën me dije se:
 - a. Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit Z. Genc Elez Merepeza,
 - b. Nuk ka ndryshuar shtetësi (lenie ose marrje shtetësie).

2. **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, me shkresën nr. ***. Prot, datë 19.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Genc Elez Merepeza, bën me dije se:
 - a. Nuk rezulton i dënuar.

3. **Institucionet Ligjzbatuese**, me shkresën nr. ***, prot, datë 25.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Genc Elez Merepeza, bën me dije se:
 - a. Nuk kanë të dhëna/informacione të vërtetuara që janë të përfshirë ose të dyshuar për përfshirjen e tyre në krimin e organizuar.
 - b. Nuk kanë të dhëna/informacione për kontakte të papërshtatshme.
 - c. Nuk kanë të dhëna në lidhje me cënimin e sigurisë kombëtare.

4. **Institucion Ligjzbatues**, me shkresën nr. ****prot., datë 30.05.2023 dhe shkresë nr. **** datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Genc Elez Merepeza si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, **nuk kanë:**
 - a. Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
 - b. Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në *krimin e organizuar*, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”) ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;
 - c. Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (*persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar*);

- d. Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;
 - e. Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;
 - f. Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
 - g. Të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
 - h. Të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-s;
 - i. Të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet,
 - j. Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.
5. **Institucion Ligjzbatues**, me shkresën nr. ***** prot., datë 31.05.2023., për subjektin e vlerësimit për subjektin e vlerësimit Z. Genc Elez Merepeza, bën me dije se:
- a. Nuk disponon të dhëna.
6. **Institucion Ligjzbatues**, me shkresë nr. ***** prot., datës 13.06.2023, shkresën nr. ***** prot., datë 19.06.2023 , Z. Genc Elez Merepeza dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:
- a. Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të paligjshëm;
 - b. Nuk ka procedime penale të referuara;
 - c. Për subjektin e vlerësimit nuk administrohen ankesa, të dhëna ose informacione;
7. **Institucion Ligjzbatues**, me shkresën nr.***. Prot, datë 31.10.07.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Genc Elez Merepeza, bën me dije se, **nuk**:
- a. Është nxjerrë urdhër ndalimi;
 - b. Është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
 - c. Është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
 - d. Ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale;
 - e. Ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
8. **Institucion Ligjzbatues**, me shkresën nr. ***** prot, datë 18.05.2023 bën me dije se për subjektin e vlerësimit Genc Merepeza dhe personat e lidhur me të:
- a. Rezultuan raportime, për të cilat pas verifikimeve të kryera janë të dhëna rutinore të raportuara nga bankat në kuadër të informim.
9. **Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën nr. ***, prot, datë 25.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Genc Elez Merepeza, bën me dije se:

- a. Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin “Tepër Sekret” lëshuar më datë 20.03.2023, e vlefshme deri më datë 15.08.2026.
- b. Për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
- c. Nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

10. **Avokati i Popullit**, me shkresën nr.***, Prot, datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Genc Eles Merepeza, bën me dije se:

- a. Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- b. Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.


11. **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**, me shkresën, nr.***. Prot, datë 08.06.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Genc Eles Merepeza, bën me dije se:

- a. Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri 2 Korrik 1991.


Denoncime nga publiku

Për subjektin e vlerësimit z. Genc Merepeza nuk është disponuar asnjë ankesë nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

* Trupa e vlerësimit pas analizimit të dokumentacionit të administruar dhe fakteve të reja të konstatuara gjatë hetimit administrative të deklaratës së pasurisë ka kryer verifikime shtesë.

 **DPPSH** me shkresën nr. *** prot, datë 06.12.2023 ka konfirmuar se shtetasja N.P ka përdorur dy identitete :

- në shtetin shqiptarë N.P, ditëlindja 20.09.1969, ID G95921042R dhe
- në shtetin anglez Sh.G me nr. dokumenti 533368078

 **Drejtoria e Analizës dhe Kartotekës pranë AMP-së** me shkresën nr. *** datë 12.12.2023, ka konfirmuar se për punonjësit e policisë Q. B, M.M, D.SH, S.H nuk disponohen të dhëna për përfshirjen e tyre në veprimtari të kundërligjshme_ për punonjësin. R.Sh rezultojnë të dhënat e mëposhtme:

1. Informacion nr.***, datë 13.02.2014, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit(fotokopje),
2. Vendimi me nr. ***, datë 16.04.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlore për caktimin e masës së sigurimit personal, me karakter ndalues atë të "Pezullimit të ushtrimit të një detyre a shërbimi publik", ndaj të dyshuarit R. Sh.

Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka verifikuar të dhënat për këta shtetas në sistemet e Policisë së Shtetit ku nuk kanë rezultuar me precedent penal.

✚ Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, për përdorim lëndësh narkotike, me nr. ***, datë 11.01.2024, “Akt Ekzaminimi Toksikologjiko-Ligjor” kolaudohet se subjekti vlerësimit **z. Genc Merepeza:**

- **Nuk janë zbuluar prania e substancave narkotike.**

✚ Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Genc Merepeza, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit z. Genc Merepeza:

- ***Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;***
- ***Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.***

C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

- ✚ Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.
- ✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit, dërguar me shkresën nr. 36/11 prot., datë 05.07.2023, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar

Subjekti i vlerësimit **Z. Genc Merepeza** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e “e Drejtor i Kabinetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit”. Në momentin e hedhjes së shortit dhe përzgjedhjes së trupës së vlerësimit datë 05.04.2023 subjekti i vlerësimit mbante po funksionin e Drejtor i Kabinetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

✚ Periudha e vlerësimit në zbatim të nenit 44 pika 2 të ligjit 12/2018 i ndryshuar është periudha 5-vjeçare (2018-2022). Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale do të shkrihet brenda këtij harku kohor.

✚ **C/1 RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL POLICIA E SHTESTIT.**

Struktura e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr.12/2018 i ndryshuar ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr. ***, datë 30.06.2023, raportin e vlerësimit profesional është shprehur me Konkluzion përfundimtar si më poshtë vijon:

✚ **“Punonjësi i Policisë z. Genci Elez Merepeza është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban”.**

✚ **C/2 HETIMI I TRUPËS SË VLERËSIMIT PRANË AGJENCISË SE MBIKËQYRJES POLICORE:**

✚ Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me ligjin e vlerësimit si dhe ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, ka zhvilluar një hetim administrativ të plotë dhe të bazuar në fakte dhe prova duke u bazuar në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.
 - Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.
- ✚ Punonjësi i Policisë, Drejtues i Parë Genc Elez Merepeza është i emëruar në detyrë Drejtorit i Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm me Urdhrin nr.*** datë 22.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- ✚ Në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Genc Merepeza e bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

Vlerësimi i nivelit të arsimit.

Niveli i arsimit	Profesioni	Fillimi	Përfundimi
Arsim i Mesëm	Agronom	01.09.1977	30..06.1981
Arsim i Lartë (DND)	Specialist i lartë policie (kufi)	01.09.1982	30.06.1985

Konkluzion:

- ✓ Trupa e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore administroj nga dosja e subjektit të vlerësimit diplomën me nr. regjistri ***;
- ✓ Në kuptim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

Ecuria në karrierë

Nga verifikimi i të dhënave të deklarimit të subjektit të vlerësimit, raportit të vlerësimit profesional nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, subjekti i vlerësimit Genc Merepeza ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 29 vitesh e 3 muaj. Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare objekt deklarimi, subjekti mban:

Institucionit ku punon/ka punuar	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Pozicioni
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	23.11.2023	Vazhdim	Tiranë	Drejtor: Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit
Akademia e Sigurisë	01.05.2018	22.11.2022	Tiranë	Profesor: Departamenti i Ruajtjes dhe Sigurisë, ne Akademinë e Sigurisë
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	01.06.2017	30.04.2018	Tiranë	Shef Sektori: Sektori i Planifikimit Strategjik ne Drejtorinë e Studimeve Strategjike

Gradën “Drejtues i Parë”

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. Urdhrit	Data	
			Nga	Deri
Drejtues i Parë	Larguar nga Detyra Drejtorit të Përgjithshëm	Nr. 809 datë 27.04.2017	28.04.2017	

Konkluzion:

- ✓ Subjekti i vlerësimit, Genc Mereçoza është transferuar dhe emëruar në pozicionin aktual me Urdhër nr. ***, datë 22.11.2022 në përputhje me në nenin 43, pikat 4 dhe 6, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, neni 180 pika 2, shkronja “b”, të Rregullores së Policisë së Shtetit, e ndryshuar.
- ✓ Me urdhër nr. ***, datë 27.04.2017, “Për dhënien e gradës policore dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie”, bazuar në ligjin nr.108/2014,i ndryshuar të Policisë së Shtetit dhe Rregullores së Policisë së Shtetit, të ndryshuar subjektit të vlerësimit i është dhënë grada policore “Drejtues i Parë”.
- ✓ Sipas deklarimeve të vetë subjektit dhe vërtetimeve që ka sjellë, ai ka një karrierë në Policinë e Shteti rreth 29 vite e 3 muaj.

Trajnime / Kualifikime

- Trupa e vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstatohet se gjatë periudhës 5 vjeçare të vlerësimit në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar.

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale , pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe verifikimeve në sistemin RMIS, subjekti për periudhën e përcaktuar në ligjin 12/2018, i ndryshuar ka kryer trajnim me temë “Standardet evropiane të kërkimeve shkencore dhe botimeve të tyre”, për të cilin është edhe pajisur me Certifikatë.

Vlerësimet e Punës.

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale , pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe verifikimeve në sistemin RMIS, subjekti për periudhën 2018-2023 objekt verifikimi ka rezultuar lidhur me “Vlerësimin e rezultateve individuale të punës”, sipas viteve ka rezultuar si më poshtë:

• Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018	28 pikë	Shumë mire
• Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019	28 pikë	Shumë mire
• Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020	28 pikë	Shumë mire
• Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021	28 pikë	Shumë mire
• Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022	100 pikë	Shumë mire

Gjendur në këto kushte Trupa e vlerësimit me shkresën nr. *** datë 14.07.2023 kërkoj nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit vlerësimet e punës për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, ku me kthim-përgjigjen nr. *** datë 21.07.2023 Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Policisë së Shtetit u konfirmua fakti se vlerësimet e punës për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, për subjektin e vlerësimit z .Genc Merepeza nuk rezultojnë të administruar në dosjen e personelit.

Për sa më sipër subjekti i vlerësimit me **emailin e datës 28.12.2023** ka paraqitur vlerësimin e punës për vitin 2019.

Masa Disiplinore

Nga verifikimet në dosjen personale si dhe në sistemin RMIS, rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018-2023) të përcaktuar në pikën 2 të nenit 44 të ligjit 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit, nuk është ndëshkuar disiplinarisht me ma së disiplinore.

Trupa e vlerësimit konstaton se subjekti përgjatë periudhës së vlerësimit nuk ka asnjë masë disiplinore në ngarkim.

Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit Genc Merepeza:

- ✓ **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- ✓ **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;**
- ✓ **Ka vlerësime pozitive pune.**

Konkluzione përfundimtare:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 02.02.2024, ftoj subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 22.02.2024, dhe arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Genci Elez Merepeza , në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;***
- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;***
- ***Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.***

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në bazë të gjurmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit Genc Merepeza me funksion Drejtor Kabineti, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ky vendim u shpall sot datë 22.02.2024, në Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë 22.02.2024.

KRYESUES

KLEADA MERSINLLARI

RELATOR

EDONA DUSHAJ

ANËTAR

ENTON RADOVANI